



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 96, datë 21.06.2019

**PËR
PËRSËRITJEN E TRANSFERIMIT TË PËRKOSSHËM TË GJYQTARIT
GENTI DOKOLLARI NË GJYKATËN E RRETHIT GJYQËSOR KAVAJË**

Këshilli i Lartë Gjyqësor mbështetur në nenin 46 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në vendimin nr. 23, datë 07.02.2019 të KLGJ-së “Mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit”, i ndryshuar, në vendimin nr. 89, datë 17.06.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si dhe duke mbajtur në konsiderate dhënien e pëlqimit të gjyqtarit Genti Dokollari me shkresën nr.3286, datë 18.06.2019, me propozim të Komisionit për Zhvillimin e Karrierës,

V E N D O S I:

1. Gjyqtarit Genti Dokollari, aktualisht gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, i përsëritet transferimi i përkohshëm, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë, për një periudhë deri në 1 (një) vit, nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.
2. Njoftimin e këtij vendimi gjyqtarit Genti Dokollari, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë si dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR